



Datë: 04.03.2025

Numër Protokolli: 1748/2025

A.nr.08/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.08/2025 të datës 03.01.2025, të parashtruar nga ankuesi B.K kundër organit të punësimit/Ministria e Punëve të Brendshme në çështjen juridike “*Kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 04.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Detyrohet Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi të shqyrtoj Kërkesën me numër protokolli 1355 të datës 03.10.2024, të parashtruar nga ankuesi B.K, dhe të nxjerr akt administrativ në pajtueshmëri me dispozitat ligjore në fuqi.

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, B.K (*tutje referuar vetëm: Ankuesi*), më datë 03.01.2025, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 08/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative nga Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme, lidhur me kërkesën e datës 03.10.2024, për dhënien e vërtetimit me shkrim për përmbajtjen e “aktit administrativ të miratuar në heshtje”.

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesi sipas Akt emërimit me numër reference Nr.Ref: DSP 7/13 të datës 22.08.2013, është i punësuar në pozitën e punës “*Zyrtar i lartë për shënjim, gjurmim, deaktivizim dhe shkatërrim*”, në Departamentin e Sigurisë Publike.

Tutje, nga shkresat e lëndës rrjedhë se ankuesi, më datë 04.07.2024, ka parashtruar kërkesë, në lidhje me aprovimin për udhëtim zyrtar ndërsa i njëjti gjithashtu përmes kësaj kërkesë ka kërkuar edhe kompensimin e mëditjeve, gjithashtu më datë 03.10.2024 ankuesi ka parashtruar kërkesë pranë organit të punësimit duke kërkuar dhënien e vërtetimit me shkrim për përmbajtjen e “aktit administrativ të miratuar në heshtje”, mirëpo nga shkresat e administruara të lëndës dhe thëniet si në ankesë rezultojnë se i njëjti nuk ka pranuar përgjigje nga organi përkatës i punësimit në raport me Kërkesën e fundit atë të datës 03.10.2024.

Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me rregullat e veprimeve procedurale të një organi publik, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (*tutje referuar: LPPA*), përkatësisht nenit 10 paragrafi 2 ku përcaktohet se: 2. *Organi publik zhvillon procedurën administrative sa me të shpejtë dhe me sa më pak shpenzime, për të dhe për palën, duke mos cenuar çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm e të përshtatshëm të procedurës administrative*, nenit 98 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: 1. *Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure*. 2. *Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj, si dhe nenit 97 paragrafi 1 të këtij ligji, ku përcaktohet se: 1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative, dhe si rrjedhojë në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në shqyrtimin e provave materiale të çështjes, Kolegji i Këshillit konstatoi se organi përkatës i punësimit, në rrethanat e rastit konkret, nuk ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat përkatëse ligjore, në raport me Kërkesën me numër protokolli 1353 të datës 03.10.2024, të parashtruar nga ankuesi, ngase sipas bazës ligjore si me sipër, vullneti i organit publik në realizimin e autoritetit publik formësohet në procedurë administrative dhe manifestohet në formën e njërit prej veprimeve administrative, siç janë: akti administrativ; kontrata administrative apo akti real, dhe se në vlerësimin e Kolegjit, organi përkatës i punësimit, në kuadër të autorizimeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, është dashur që të nxjerr akt administrativ në kuptim të vendosjes dhe të njoftoj palën për aktin e tillë, brenda një afati prej 45 ditësh sikurse përcaktohet me nenin 98 paragrafi 2 apo afatit të vazhduar sipas nenit 99 paragrafi 1 të LPPA-së.*

Rrjedhimisht, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, heshtja e organit të administratës, në ketë rast, Sekretares së Përgjithshme në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në raport me Kërkesën e datës 03.10.2024, cenon të drejtat e ankuesit në kuptimin e të drejtave procedurale dhe për rrjedhojë edhe vendosjes në mënyrë meritore, ngase ashtu sikurse është thënë në arsyetim të këtij vendimi, në kërkesën e parashtruar të organi i punësimit, ankuesi pretendon realizimin e kompensimit të mëditjeve, që nga hyrja në fuqi e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, dhe se organi përkatës i punësimit duhet të shqyrtoj kërkesën e saj dhe të vendos lidhur me pretendimet e ngritura.

Kështu që thënë si me sipër e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi të aprovoj si të bazuar ankesën e datës 08/2025, në kuptim të shkeljeve procedurale, dhe si rrjedhojë detyroj Sekretaren e Përgjithshme në Ministrinë e Punëve të

Brendshme, që në respektim të dispozitave procedurale të shqyrtoj Kërkesën e datës 03.10.2024, dhe të nxjerr akt administrativ në përputhshmëri me dispozitat ligjore në fuqi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë Juridike: *Pala e pakënaqur, e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.08/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, B.K;
- Sekretares së Përgjithshme dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë së Punëve të Brendshme;
- Arkivit të KPMSHCK-së.